dërgohet akti apo dëshmia tjetër mbi aritjen e bazës juridike për fitimin e cilësia së
akcionerit të shoqëris.



Neni 14

Sekretari i shoqëris vendos lidhur me kërkesën e paraqitur në afat prej pesë ditësh
nëse refuzohet regjistrimi, personi që ka kërkuar regjistrim në libër të aksionarëve i
dërgohet informatë me shkrim duke e cekur arsyet e refuzimit të regjistrimit dhe atë
në afat prej pesë ditësh.

Neni 15

Nëse pranohet kërkesa për regjistrim në libër të aksionerëve, bëhet ky regjistrim dhe
ndryshohet ky statut.

Neni 16

Aksioneri i ri të drejtat e veta i realizon nga data e regjistrimit në libër të aksionarve.

VI. KAPITALI THEMELOR, NUMRI, LLOJI DHE VLERA NOMINALE E AKSIONEVE

Neni 17

Shuma e kapitalit themelor fillestar është **10.000 € (dhjetëmijë Euro)**.

Kapitali themelor e ka këtë strukturë

- Mjetet monetare (të hollat) në shumë prej **10.000 € (dhjetëmijë Euro)**.

Neni 18

Kapitali themelor fillestar i shoqëris është i ndarë në **1.000** aksione të rëndomta në
emër. Vlera nominale e një aksioni është **10 € (dhjetë Euro)**.

Shoqëria nuk i shtyp aksionet si letër me vlerë por pronësin mbi aksionet regjistrohet
në libër të aksionerëve të shoqëris (aksionet e pacertifikuar).

Me kërkesën e cdo pronari të aksioneve shoqëria mund të lëshoj vërtetimin mbi
posedimin e aksioneve i cili përmbanë të gjitha elementet të parapara për aksione
sipas gjendjes së fundit të regjistruar në librin e aksionerve të shoqëris



	Emërtimi	Pjesëmarrja %	Numri i aksioneve	Vlera e një aksioni në Euro	
1.	Cmc Ekocon d.o.o Lubljanë	51	510	10	5.100
2.	Cmc Ekocon d.o.o Shkup	26	260	10	2.600
3.	Sylejman Behra	23	230	10	2.300
	Gjithsej:	100	1.000	10	10.000

Neni 19

Shoqëria në rastin e zmadhimit – rritjes së kapitalit përmes emetimit të aksioneve shtesë i emeton akcionet e rregullta në emer apo akcionet prioritare ne emer pa të drejtë vote.

VII. TE DREJTAT E AKCIONERIT TË SHOQËRISË

Neni 20

Akcioneri i shoqëris i ka këto të drejta:

- Të drejtën në dividend sipas dispozitave të këtij statuti
- Të drejtën në shpërndarjen falsë të aksioneve të shoqëris nëse fitimi i realizuar nuk shpërndahet në dividend por për shumën e fitimit zmadhohet kapitali themelor i shoqëris e nuk rritet vlera nominale e aksioneve ekzistuese
- Të drejtën e lënjes peng të aksioneve me gëzimin e të drejtës në votë apo pa të mvarësisht nga marëveshja e pengut
- Të drejtën në votë për cdo akcion të cilën e ka në pronësi
- Të drejtën në shitjen apo në transferim në mënyrë tjetër të aksioneve
- Të drejtën në lënjen në trashigim të aksioneve
- Të drejtën e pjesmarrjes në qeverisje me shoqëri sipas këtij statuti
- Të drejtën në informim në lidhje me veprimtarin dhe afarizmin e shoqëris në pajtim me këtë statut
- Të drejtat tjera të caktuara me ligj apo më këtë statut

Neni 21

Shoqëri mund të marr në peng akcionet e veta në vlerë nominale deri në 10% të kapitalit themelues të shoqëris
Kontratën mbi lënjen peng të aksioneve të shoqëris në shoqëri e miraton Kuvendi i shoqëris

Neni 22



Themeluesi akcionet e veta mund ti bartë në persona të tjerë, sipas vlerës nominale apo vlerës tjetër

Bartja e tërësishme apo e pjesërishme e akcioneve të shoqëris në person tjetër nuk është e kufizuar

Mbi transferimin e akcioneve të shoqëris lidhet kontrata me shkrim me të cilën përcaktohen kushtet e mbajtjes apo të shitjes së akcioneve

Transferimi i akcioneve të shoqëris ka ndikim ndaj shoqëris prej momentit të regjistrimit në libër të akcionerve të shoqëris.

EMRIMI I DREJTORIT

Neni 23

Drejtori i "CMC EKOCON" sh.p.k është **Sylejman Behra** me vendbanim të përhershëm në **Prishtinë, Rr.28 Nëntori, Su I/5-4, Nr.17.**

Neni 24

Shoqëria e ka vulën kryesore dhe vulën datore. Vula kryesore është e rumbullakët dhe shërben për të dëshmuar vërtetësin e nënshkrimit të personit të autorizuar për përfaqësim apo prezentim të shoqëris.

Vula datore është katrore dhe shërben për të dëshmuar vërtetësin e pranimit apo dorëzimit të akteve apo shkresave dhe shënimit të numrit dhe datës së aktit apo pranimit ose dorëzimit të aktit apo shkresës.

Neni 25

Teksti në vulën kryesore dhe vulën datore shkruhet në gjuhën Shqipe dhe gjuhën Angleze me përmbajtje të njëjtë.

Me vendim të drejtorit të shoqëris caktohet dukja dhe përbërja e vulës kryesore dhe vulës datore. Për përdorimin e vulave përgjegjës është drejtori i shoqëris.

VIII. NDRYSHIMET E STATUTIT

Neni 26

Ky statut ndryshohet dhe plotësohet në cdo rast kur konstatohet se nuk është i harmonizuar me ligj dhe kur konstatohet se mënyra e regullimit të ceshtjeve në të nuk është në pajtim me interesat e akcionerve dhe është penges për afarizmin e shoqëris në raste të parapara në dispozitat e mëparshme dhe kur ekziston nevoja e arsyeshme.

Neni 27

Ndryshimet dhe plotësimet e statutit i bënë kuvendi i shoqëris në ndryshimet dhe plotësimet e statutit sipas iniciativës së tij, iniciativë të drejtorit apo të themeluesit.
Nëse kuvendi nuk e miraton iniciativën për ndryshimet dhe plotësimet i obliguar që paraqitësin e iniciativës të informon mbi shkaqet e mospranimit të iniciativës.



Neni 28

Ky statut nxiret në procedurën e caktuar më ligj dhe dispozitave të këtij statuti mbi nxerjen e akteve të përgjithshme në shoqëri.
Ndryshimet dhe plotësimet e statutit bëhen sipas procedurës të paraparë për nxerjen e tijë.
Nëse me ndryshimet dhe plotësimet e statutit ndryshohen të dhënat e regjistruara në regjistrin përkatës ndryshimet dhe plotësimet hyjnë në fuqi në afat prej 8 ditësh nga data e shpalljes

IX. DISPOZITAT KALIMTARE E TË FUNDIT


Neni 29

Ky statut hyn në fuqi 8 ditë nga data e publikimit të tijë në tabelën e shpalljeve të shoqëris.
Aktet e përgjithshme të parapara me këtë statut do të nxiren në afat prej 30 ditësh nga data e hyrjes në fuqi të statutit

Neni 30

Për qështjet të cilat nuk janë rregulluar në këtë statut aplikohen dispozitat e vendimit mbi themelim dhe dispozitat e ligjit .

KRYETARI I KUVENDIT THEMELUES




Sylejman Behra

1 a

**“CMC EKOCON” Sh.p.k, SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI
KUFIZUAR PRISHTINË**



**AKTI
MBI THEMELIMIN E “CMC EKOCON”, SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR PRISHTINË**

PRISHTINË, Nëntor 2003

Në bazë të nenit 23.5. dhe 25.1. të Rregullores së UNMIK-ut No. 2001/18 për shoqëri tregtare, me 27 Nëntor 2003 CMC EKOCON d.o.o me seli në Lubljanë, Tbilisjska Nr.81, Republika e Sllovenisë, CMC EKOCON d.o.o me seli në Shkup, Bulevardi Ilinden, Nr.3-47, Maqedoni dhe Sylejman Behra me vendbanim të përhershëm në Prishtinë, Rr.28 Nëntori, Su I/5-4, Nr.17, si themelues të Korporatës nxjerrin këtë:



AKT

MBI THEMELIMIN E "CMC EKOCON", SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR PRISHTINË

Neni 1. Dispozitat e përgjithshme

1.1. Me këtë akt themelohet "CMC EKOCON" sh.p.k. PRISHTINË si shoqëri tregtare të kapitalit në formë të shoqëris me përgjegjesi të kufizuar (në tekstin e mëtejshëm "Korporata" apo "Shoqëria" mvarësisht nga kontesti i fjalisë) dhe e përcakton:

- Themeluesin e shoqëris
- Firmën dhe Selin e shoqëris
- Veprimtarin e shoqëris
- shumën e kapitalit themelues
- strukturën e tij mënyrën dhe kohën e deponimit në kapital të shoqëris
- llojet e akcioneve si pjesmarrje në kapitalin themelues dhe shpërndarja e këtyre akcioneve
- të drejtat, obligimet dhe përgjegjësit e themeluesit lidhur me themelimin
- procedurën e themelimit
- mënyra e miratimit të statusit dhe rregulloren në shoqëri
- çështjet tjera lidhur me themelimin, punën dhe afarizmin e shoqëris

1.2. Çështjet tjera lidhur me themelimin dhe afarizmin e shoqëris te cilat nuk janë përcaktuar në këtë akt do të rregullohen me statut të shoqëris dhe me akte tjera të përgjithshme .

1.3. Korporata e themeluar me këtë akt e ka cilësin e shoqëris një personale tregtare të kapitalit.

Korporata e ka cilësin e personit juridik dhe e kryen veprimtarin e përcaktuar me këtë akt dhe statut për të realizuar fitim.

1.4. Punët lidhur me themelimin e shoqëris deri tek regjistrimi i shoqëris në regjistër përkatës i kryen themeluesi apo personi të cilin ai e autorizon

1.5 Themeluesit i bartin të gjitha shpenzimet lidhur me themelimin e shoqëris deri në momentin e regjistrimit të shoqëris në regjistër përkatës.

Themeluesit kanë të drejtë në kompenzimin e shpenzimeve nga ky nen.

Kompenzimi i shpenzimeve do të bëhet nga fitimi të cilin shoqëria e realizon në vitin parë të afarizmit. Pjesa e këtyre shpenzimeve ka prioritet në krahasim me pagesat tjetra nga fitimi përveq pagesave në bazë të ardhurave publike



1.6. Shoqëria themelohet në kohë të pacaktuar dhe do ta afaron në pajtim me ligjin.

Neni 2. Themeluesi i shoqëris

2.1. Themeluesit e shoqërisë janë:

CMC EKOCON d.o.o me seli në Lubljanë, Rr.Tbilisijaska, Nr.81, Republika e Sllovenisë.

CMC EKOCON d.o.o me seli në Shkup, Bulevardi Ilinden, Nr.3-47, Maqedoni.
Sylejman Behra me vendbanim të përhershëm në Prishtinë, Rr.28 Nëntori, Su I/5-4, Nr.17.

2.2. Akcionar dhe anëtar i shoqëris mund të bëhet edhe personi tjetër në të cilin mbarten akcionet e shoqëris apo personi i cili në bazë të vendimit mbi zmadhimin e kapitalit themelues përmes emetimit të akcioneve shtesë e bënë blerjen e këtyre akcioneve

Neni 3. Firma dhe selia e shoqëris

3.1. Shoqëria e themeluar me këtë akt do të afaron në firmen:

“CMC EKOCON” shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Shkurtesa e shoqëris është:

“CMC EKOCON” sh.p.k.

Firma dhe shkurtesa e firmës së shoqëris shkruhet në gjuhën Shqipe, Angleze dhe Sërbe.

Firma dhe shkurtesa e firmës së shoqëris regjistrohet në regjistër në të cilin është regjistrua shoqëria

3.2. Në qarkullimin juridik me persona të tretë, varësisht nga natyra e mardhënjes juridike apo të komunikimit, shoqëria paraqitet nën firmën apo shkurtesës së firmës.

Pjesa apo njesi afarite e shoqëris, me apo pa autorizime në qarkullim juridik, paraqitet në firmën apo shkurtesën e firmës së shoqëris dhe emrin e vet.

3.3. Firma dhe shkurtesa e firmës së shoqëris mund të ndryshohet me vendimin e kuvendit të shoqëris.

3.4. Shoqëria në pajtim me ligj e mbron emrin e vet.

3.5. E drejta në shfrytëzimin e emrit të shoqëris nuk mund të bartet në persona të tjerë.



- 3.6. Selia e shoqërisë është në Prishtinë, Rr. Eqrem Qabej, Nr-51. Shoqëria mund të ndryshon selin e vet me vendimin e kuvendit të shoqërisë.
- 3.7. Shoqëria e ka shenjë mbrojtëse e cila caktohet me statut të shoqërisë sipas ligjit të posaqëm.

Neni 4. Veprimtaria e shoqëris

4.1. Veprimtaritë e shoqëris janë:

- 01.41 Shërbime plotësuese në kultura bujqësore.
- 15.98 Prodhimi i ujit mineral dhe i pijeve freskuese.
- 22.33 Riprodhimi i shënimeve të makinave llogaritare.
- 29.11 Prodhimi i motorve dhe turbinave përveq motorve për aeroplan dhe automjete
- 29.12 Prodhimi i pompave dhe kompresorëve.
- 29.13 Prodhimi i rubinetave dhe ventileve .
- 29.14 Prodhimi i kushinetave dhe ingranazhit tjetër e paisjeve.
- 29.24 Prodhimi i makinave të tjera me destinim të përgjithshëm, pc.
- 29.40 Prodhimi i makinave për vegla.
- 31.10 Prodhimi i elektromotorëve, gjeneratorëve dhe transformatorëve.
- 31.20 Prodhimi i paisjeve të shpërndarjes dhe të kontrollit të energjisë elektrike.
- 31.30 Prodhimi i telit të izoluar dhe kablllove.
- 31.40 Prodhimi i akumulatorëve, i stacioneve dhe baterive elektrike.
- 31.50 Prodhimi i llampave dhe aparateve të ndriqimit.
- 31.62 Prodhimi i paisjeve të tjera elektrike.
- 33.20 Prodhimi i instrumenteve dhe aparateve për matje, kontroll, hulumtim.
- 33.30 Prodhimi i paisjeve të kontrollit të proceseve industriale.
- 37.10 Riciklimi i mbeturinave dhe hedhurinave metalike.
- 40.10 Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike.
- 40.30 Furnizimi me avull dhe me ujë të ngrohët.
- 45.31 Vendosja e instalimeve elektrike.
- 45.33 Vendosja e instalimit për ujë, gaz, ngrohje, ventilacion dhe për ftohje.
- 45.34 Punimet të tjera të instalimeve.
- 50.10 Tregëtia e automjeteve motorike.
- 50.30 Tregtia e pjesëve të këmbimit për automobila.
- 51.12 Ndërmjetësimi në tregëtinë e lëndëve djegëse, xeheve, metaleve dhe produkteve industriale kimike.
- 51.14 Ndërmjetësimi në tregtin e makinave, pajisjeve industriale anijeve dhe lëkure.
- 51.15 Ndërmjetësimi në tregëtinë e mobilieve, produkteve shtëpiake dhe të galanterisë.
- 51.16 Ndërmjetësimi në tregëtinë e tekstilit, veshjeve, këpucëve dhe artikujve prej lëkure.
- 51.17 Ndërmjetësimi në tregëtinë e ushqimit, pijeve dhe duhanit.
- 51.18 Ndërmjetësimi në tregëtinë e specializuar për shitje të produkteve të përziera.
- 51.19 Ndërmjetësimi në tregëtinë e produkteve të tjera.
- 51.52 Tregtia me shumicë e mineraleve dhe metaleve.
- 51.53 Tregtia me shumicë e lëndëve drurore dhe metaleve.



- 51.54 Tregëtia me shumicë e artikujve të imë metalik, materialit instalues dhe pajisjeve elektrike dhe ngrohjes.
- 51.55 Tregëtia me shumicë e produkteve kimike.
- 51.56 Tregëtia me shumicë e gjysëm produkteve të tjera.
- 51.64 Tregëtia me shumicë e makinave të zyreve dhe pajisjeve informatike.
- 51.65 Tregëtia me shumicë e makinave të tjera që përdoren në industri, tregëti dhe në lundrim.
- 51.66 Tregëtia me shumicë e makinave bujqësore, mjeteve bujqësore, duke përfshirë edhe tragëtorët.
- 51.70 Tregëtia tjetër me shumicë.
- 60.30 Transporti i kanalizuar-me anë të gypave.
- 63.12 Magazinimi i mallit.
- 67.13 Veprimtaritë ndihmëse të ndërmjetësimit financiar, p.c.
- 70.11 Krijimi i pasurisë së re të patundshme dhe shitja e pasurisë së patundshme.
- 72.10 Ofrim këshillash për pajisjet llogaritëse (hardwar-it).
- 72.20 Këshillime dhe sigurimi i pajisjeve programore(softwar-it).
- 72.30 Përpunimi i të dhënave.
- 72.40 Përpunimi dhe udhëheqja e bazave të dhënave.
- 72.60 Veprimtaritë të tjera të lidhura me makinat llogaritëse(informatike).
- 74.14 Këshillime lidhur me afarizëm dhe administrim.
- 74.15 Veprimtaritë administrative të shoqatave-holding.
- 74.20 Veprimtaritë e arkitekturës dhe inxhinieris dhe këshillime lidhur me to.
- 74.30 Kontrollime teknike dhe analiza.
- 74.40 Publiciteti(reklammat dhe propaganda).

4.2. Shoqëria i kryen edhe punët e shoqëris së jashtme dhe ndërmjetësimit në tregti të jashtme dhe import-export të të gjitha mallrave, produkteve dhe shërbimeve.

4.3. Veprimtaria e shoqëris mund të ndryshohet apo të zgjerohet në bazë të vendimit të kuvendit të shoqëris

Neni 5. Kapitali themelues fillestar

5.1 Shuma e kapitalit themelor fillestar është **10.000 € (dhjetëmijë Euro).**

Kapitali themelor e ka këtë strukturë

Mjetet monetare (të hollat) në shumë prej **10.000 € (dhjetëmijë Euro).**

5.2. Kapitalin themelues fillestar e deponon themeluesi i shoqëris me deponimin e mjeteve personale.

5.3. Mjetet monetare nga neni 5.1 të këtij akti themelues do ti paguaj në shoqëris në afat prej 24 orësh nga data e regjistrimit dhe hapjes së llogarit në shoqëris në ndonjë bankë afariste.



Mjetet jo monetare (deponimet në natyrë) nga neni 5.1. i këtij akti, themeluesi do të vëjë në disponim shoqëris në afat prej 24 orësh nga data e mbajtjes së mbledhjes së kuvendit themelues.

Neni 6. Lloji i akcioneve të shoqëris

6.1. Kapitali themelor fillestar i shoqëris është i ndarë në **1.000** aksione të rëndomta në emër. Vlera nominale e një aksioni është **10 (dhjetë Euro)**.

Shoqëria nuk i shtyp aksionet si letër me vlerë por pronësin mbi aksionet regjistrohet në libër të akcionerëve të shoqëris (aksionet e pacertifikuar).

Me kërkesën e cdo pronari të akcioneve shoqëria mund të lëshoj vërtetimin mbi posedimin e akcioneve i cili përmbanë të gjitha elementet të parapara për akcione sipas gjendjes së fundit të regjistruar në librin e akcionerve të shoqëris

Nr.	Emërtimi	Pjesëmarrja %	Numri i akcioneve	Vlera e një aksioni në Euro	Shuma Euro
1.	Cmc Ekocon d.o.o Lubljanë	51	510	10	5.100
2.	Cmc Ekocon d.o.o Shkup	26	260	10	2.600
3.	Sylejman Behra	23	230	10	2.300
Gjithsej:		100	1.000	10	10.000

6.2. Themeluesit aksionet e veta mund ti bartin në persona të tjerë, sipas vlerës nominale apo vlerës tjetër

6.3. Bartja e tërësishme apo e pjesërishme e akcioneve të shoqëris në person tjetër nuk është e kufizuar.

6.4. Mbi transferimin e akcioneve të shoqëris lidhet kontrata me shkrim me të cilën përcaktohen kushtet e mbajtjes apo të shitjes së akcioneve.

Transferimi i akcioneve të shoqëris ka ndikim ndaj shoqëris prej momentit të regjistrimit në libër të akcionerve të shoqëris.

Neni 7. Libri i akcionerve të shoqëris

7.1. Në shoqëri mbahet libri i akcionerve të shoqëris në mënyrë të caktuar në statut të shoqëris

7.2. Regjistri i akcionerve të shoqëris mbahet në selin e shoqëris dhe udhëhiqet nga Sekretari i shoqëris.



Neni 8. Paraqitja në qarkullim juridik dhe përgjegjësia për obligime

8.1. Shoqëria është person juridik dhe bartës i të drejtave dhe obligimeve në qarkullim juridik.

Në qarkullimin juridik shoqëria paraqitet në mënyrë të pamvarur

8.2. Për obligimet e krijuara në qarkullimin juridik shoqëria përgjigjet me të gjitha mjetet me të cilat disponon.

Obligimet e shoqëris përmbushen nga mjetet me cilat shoqëria disponon

Shoqëria nuk përgjigjet për obligimet personale të themeluesit.

Neni 9. Menagjimi në shoqëri

9.1. Shoqërin e administron dhe me të udhëheqin themeluesit si akcionar të shoqëris.

9.2. Organet e shoqëris janë kuvendi i shoqëris i cili vendos në mbledhjen e themelimit, mbledhjet e përgjithshme vjetore dhe ne mbledhjet e jashzakonëshme dhe drejtori i shoqëris si organ punë drejtues.

9.3. Në shoqëri në pajtim me dispozitat e nenit 34.2. të Regullorës së UNMIK-ut Nr. 2001/6 – Për shoqëri tregtare nuk emrohet bordi drejtues. Kuvendi i shoqëris e kryen dhe funksionin e bordit drejtues

Drejtori i shoqëris e organizon dhe e udhëheq procesin e punës dhe të afarizmit të shoqëris, e përfaqëson dhe e prezton shoqërin para personave të tretë dhe kujdeset mbi ligjeshmërin e afarizmit të shoqëris

9.4. Vendimet e kuvendit dhe të drejtori të shoqëris lidhur me administrimin e shoqëris regjistrohen në librin e vendimeve të shoqëris

Në libër nga alinea e mëparshme regjistrohen vendimet mbi aprovimin e llogarive, treguesve dhe raporteve të afarizmit, vendimet mbi shpërndarjen e fitimit dhe mbulimit të humbjeve, vendimet mbi rritjen dhe zvogelimit të kapitalit themelor, vendimin mbi investime etj.

Neni 10. Përfaqësimi dhe prezentimi i shoqëris

10.1. Shoqërin e përfaqëson dhe e prezenton para personave të tretë drejtori i shoqëris pa kufizime.

Drejtori i shoqëris mund të autorizoj personin tjetër për përfaqësim dhe prezantim të shoqëris. Lëmin dhe kufirin e autorizimit e cakton drejtori i shoqëris në rast të lëshimit të autorizimit.



10.2 Drejtori i shoqëris e përfaqëson dhe e prezenton shoqërin edeh në punët e regjistër së jashtme pa kufizime.

10.3. Shoqëria mund ti jap prokurën.

Vendimi mbi dhënjen e prokurës e merr kuvendi i shoqëris. Prokura mund të jetë individuale apo kolektive, të ipet për pjesën apo për shoqërin në tërësi

Neni 11. Marëdhënja e punës në shoqëri

11.1 Për kryerjen e veprimtarisë, varësisht nga nevojat e punës, shoqëria i punëson numrin e nevojshëm të punëtorëve me aftësi profesionale përkatëse

Vendimin mbi nevojën e punësimit të punëtorëve e merr kuvendi i shoqëris në bazë të propozimit të drejtorit.

Vendimin mbi pranimin e punëtorit në punë e merr drejtori i shoqëris

11.2. Të drejtat dhe obligimet e të punësuarve përcaktohen me kontrat mbi punën

Kontratën mbi punë, në rast të punësimit, me punëtor e lidh drejtori i shoqëris

Neni 12 Të drejtat, obligimet dhe përgjegjësit e themeluesit ndaj shoqëris lidhur me themelimin

12.1 Themeluesit janë të obliguar që të deponojnë kapitalin themelues fillestar në mënyrë dhe afat të përcaktuar me këtë akt dhe të ndërmarrin të gjitha aktivitetet lidhur me themelimin dhe regjistrimin e shoqëris.

12.2 Themeluesit i përgjigjen personave të tretë për detyrime se kanë të bëjë në themelimin e shoqëris dhe për detyrime të krijuara para regjistrimit të shoqëris në regjistër përkatës.

12.3 Themeluesit e shoqëris i përgjigjen shoqëris për dëm të shkaktuar me pagesë të paskohëshme të pjesmarjes së tij në kapital të shoqëris, për dëmin i cili shkaktohet me ndërmarrjen e punëve lidhur me themelimin dhe regjistrimin e shoqëris në regjistër përkatës pas kohës së paraparë dhe nëse vlera e deponimeve të cilat nuk janë bërë në monedh (deponimet në natyrë është më i vogël se vlera e përcaktuar.

Përgjegjëësia nga alineat e mëparshme përjashtohet nëse themeluesi i shoqëris ka vepruar me përgjegjësi në pajtim me rregullat e parapara me ligj.

12.4 Me regjistrimin e shoqëris në regjistrin përkatës, te drejtat dhe obligimet të cilat janë krijuar respektivisht të cilat i ka marr themeluesi deri ne regjistrim kalon në shoqëri. Kurse themeluesi për këto obligime përgjigjet sipas kontratës me personat tjerë.



Neni 13 Procedura e themelimit të shoqëris

13.1 Procedura e themelimit të shoqëris përbëhet nga nxerja e këtij aktit, mbajtjes së kuvendit për themelim, për miratimin e vendimit mbi numrin e punëtorëve mbi shoqëri, vendimit mbi emrimin të drejtorit të shoqëris dhe vendimit mbi miratimin të kapitalit themelues fillestar dhe vlerësimin e kontributeve të kapitalit themelues në natyrë (sendet) si dhe paraqitjes të akteve mbi themelim dhe aplikacioneve për regjistrim të shoqëris yek Zyra e Regjistrimit të Biznisit dhe Emrave Tregtarë.

13.2 Në afat prej 8 ditësh nga data e nxerjes së këtij akti themeluesi do të përpilon projekt statutin e shoqëris.

Neni 14 Statuti i shoqëris

14.1 Në shoqëri miratohet statuti i shoqëris. Statutin e shoqëris e miraton kuvendi i shoqëris në kuvendin për themelim të shoqëris. Statuti i shoqëris pas miratimit shpallet në tabelën e shpalljeve të shoqëris

Me statut të shoqëris do të regullohen qështjet të parapara me ligj dhe qështjet tjera lidhur me afarizmin dhe administrimin me shoqëri

14.2. Statuti është akti themelor i shoqëris. Drejtori dhe të gjithë të punësuarit duhet të veprojnë në pajtim me dispozitat e statutit të shoqëris.

Të gjitha vendimet dhe aktet tjera të shoqëris duhet të jenë në pajtim me statutin e shoqëris. Vendimet dhe dispozitat e akteve të shoqëris të cilat nuk janë në pajtim me dispozitat e statutit të shoqëris nuk mund të zbatohen. Nëse gjatë ekzistimit të shoqëris konstatohet se vendimet dhe dispozitat e akteve të tjera të përgjithshme nuk janë harmonizuar me dispozitat e statutit, zbatohen dispozitat e statutit, kurse dispozitat e vendimeve dhe të akteve të tjera të përgjithshme duhen të harmonizohen me dispozitat e statutit.

Neni 15 Fillimi i punës dhe pushimi i shoqëris

15.1 Shoqëria ia fillon punën dhe afarizmin në datën kur pas emrimit të drejtorit të shoqëris shoqëria regjistrohet në regjistër të shoqërive tregtare

15.2. Shoqëria mund të pushon me shpërbërjen e saj në raste dhe kushte të parapara me ligj dhe statut të shoqëris.

Neni 16 Hyrja ne fuqi, ndryshimet dhe plotesimet e aktit



16.1. Ky akt hyn ne fuqi me daten e nenshkrimit nga ana e themeluesit. Ky akt do te shpallet ne tabelen e shpalljeve te shoqeris.

16.2. Ndryshimet dhe plotesimet e ketij akti behen me shkrim dhe hyn ne fuqi nga data e nenshkrimit nga ana e themeluesit.

Neni 17 Dispozitat kalimtare

17.1. Shtojcat e ketij akti jane te plotefuqishme nese jane te perpiluara me shkrim dhe nese pas miratimit ne procedure te parapare jane te nenshkuara nga themeluesi.


17.2 Ky akt eshte i perpiluar ne gjuhen Shqipe dhe nenshkuar me 27 Nentor 2003 ne Prishtine ne 6 kopje identike.

THEMELUESIT

CmC Ekocon d.o.o. Lubljane

CmC Ekocon d.o.o. Shkup

Sylejman Behra





CMC
Ekocon d.o.o.

Autorizim

CMC Ekocon d.o.o., IOC Zapolje I/10, 1370 LOGATEC, i jep autorizimin e plotë Z. Shkëlzen Berisha, me nr. te pasaportës: Z 1104083, te nënshkruajë të gjitha dokumentet e nevojshme për regjistrimin e kompanisë CMC Ekocon, sh.p.k., Tiranë.

Logatec, 06.06.2005

Drejtori udhëheqës
Oliver Macinič, dipl. ing.



REPPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERVE TIRANE
NR. REP

56P

VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Tirane sot me date 28.03.2006 , para meje Noteres Xhevahire Brahaj ,Notere e dhomes se noterise Tirane, me adrese, Bulevardi “ Bajram Curri “ Pallatet e Aviacionit te Ri Tirane, u paraqit personalisht z. Fatos Lazimi, i njohur prej meje, me cilesine e perkthyesit te gjyhes Angleze,i cili deklaroi se akti i mesiperm eshte perkthyer saktesisht prej tij nga gjuha shqipe ne gjuhen Angleze, dhe nenshkroj ne prezencen time Une Noterja vertetoj nenshkrimin e tij konforme ligjit.

NOTERE
XHEVAHIE BRAHAJ



No. 05101 B | 164

Podpisana Baukje Ojdanić-van Popering, z odločbo Ministrstva za pravosodje RS št. 74/A-5/83 z dne 22.9.1983 postavljena za sodno tolmačko za angleški jezik, izjavljam, da se ta prevod povsem ujema s slovenskim izvirnikom.

The undersigned Baukje Ojdanić-van Popering, court interpreter for the English language, appointed by Decree no. 74/A-5/83, issued on September 22nd, 1983 by the Ministry of Justice, Republic of Slovenia, hereby declares that this translation entirely corresponds to the original Slovene text.

Ljubljana, 26.10.2005





Ekocon d.o.o.

VERIZIRAN I OBTI KENE

SKLEP DRUŽBENIKA PODJETJA CMC EKOCON d.o.o.

S tem sklepom Oliver Macinič, univ.dipl.inž.str., družbenik podjetja CMC EKOCON d.o.o., sklene, da se skupaj s povezanim podjetjem CMC EKOCON d.o.o., Priština in gospodom Shkelzen Berisha ustanovi podjetje CMC EKOCON d.o.o., Tirana v Albaniji.

Podjetje CMC EKOCON d.o.o., Ljubljana bo v novo ustanovljeno podjetje v tujini vplačalo svoj delež v višini 5.100,00 EUR in s tem postalo 51% lastnik podjetja CMC EKOCON d.o.o., Tirana v Albaniji.

Oliver Macinič, univ.dipl.inž.str.

Logatec, 20.10.2005



CmC

Ekocon d.o.o.

RESOLUTION OF THE SHAREHOLDER OF THE COMPANY CMC EKOCON d.o.o.

By this resolution Oliver Macinič, B.Sc. Mech. Eng., partner in the company CMC EKOCON d.o.o., decides to establish the company CMC EKOCON d.o.o., Tirana, Albania, together with the associated company CMC EKOCON d.o.o., Priština and Mr. Shkelzen Berisha.

The company CMC EKOCON d.o.o., Ljubljana will pay its share in the amount of 5,100.00 EUR into the newly established company abroad and will thereby become the 51% owner of the company CMC EKOCON d.o.o., Tirana, Albania.

Oliver Macinič, B.Sc. Mech. Eng.
(Signature)

Logatec, 20 October 2005

CmC
Ekocon d.o.o.
IOC Zapolje I/10

CmC Ekocon d.o.o., EKOLOŠKO SVETOVANJE, INŽENIRING IN ZASTOPANJE
1370 LOGATEC, IOC Zapolje I/10

Tel.: +386 1-759-08-00, Fax: +386-1-759-08-01, E-mail: info@cmc-ekocon.si

Share capital: 150,000,000.00 SIT. Registered with the District Court of Ljubljana under entry no. 1/07966/00
Registration number: 5393396, VAT no. SI87944081, TRR: 02921-0012091870 with NLB d.d. and 29000-0001911048 with

BANK AUSTRIA CREDITANSTALT
Person liable: Oliver Macinič, B.Sc. Mech. Eng.
homepage: <http://www.cmc-ekocon.com>



CmC
Ekocon d.o.o.

**Vendim i aksionarit te kompanise
CMC Ekocon d.o.o.**

Me këtë vendim, Oliver Macinič, B.sc. Mech. Eng., partner në kompaninë CMC EKOCON d.o.o., vendosë të themelojë kompaninë CMC EKOCON d.o.o., Tiranë, Shqipëri, së bashku me kompaninë bashkëpjesëmarrse CMC EKOCON d.o.o., Prishtinë dhe Z. Shkëlzen Berisha.

Kompania CMC EKOCON d.o.o., Lublanë, do të paguajë aksionet e saj në vlerë prej 5.100.00 Euro në kompaninë e posathemeluar jashtë Sllovenisë dhe, me këtë rast, do të bëhet pronar i 51% te kompanisë CMC EKOCON d.o.o., Tiranë, Shqipëri.

Oliver Macinič, B.Sc. Mech. Eng.
(nënshkrimi)

Logatec, 20 Tetor, 2005

CmC
Ekocon d.o.o.
IOC Zapolje I/10


REPPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERVE TIRANE
NR. REP

570

VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Tirane sot me date 28.03.2006 , para meje Noteres Xhevahire Brahaj ,Notere e dhomes se noterise Tirane, me adrese, Bulevardi “ Bajram Curri “ Pallatet e Aviacionit te Ri Tirane, u paraqit personalisht z. Fatos Lazimi, i njohur prej meje, me cilesine e perkthyesit te gjyhes Angleze, i cili deklaroi se akti i mesiperm eshte perkthyer saktesisht prej tij nga gjuha shqipe ne gjuhen Angleze, dhe nenshkroj ne prezencen time Une Noterja vertetoj nenshkrimin e tij konforme ligjit.

NOTERE
XHEVAHIE BRAHAJ



Based on currently ruling laws of Slovenian government and respective regulations of the Slovenian Chamber of Commerce (SCC), the general secretary of the SCC releases this

CERTIFICATE

By means of which it is certified that CMC Ekocon d.o.o., with address IOC Zapolje I/10 1370 Logatec Slovenia, manager Mr. Oliver Macinic, registration no. 5393396, and with VAT registration no. SI87944081, practices its economical activities based on the register of activities as released by the Office for the Registration of Business Companies.

CMC Ekocon d.o.o. is a regular member of the Slovenian Chamber of Commerce and possesses all the necessary licenses for the completion of its economical activities.

This certificate along with the rest of the legal documentation of the company at hand, aids in the verification of the company's legal existence, for the competent organs for the registration of Business Companies in the Rep. of Albania.

Signature

CERTIFIED MEMBER OF THE CHAMBER OF COMMERCE
AND INDUSTRY OF SLOVENIA

Bm

BOGOMILA METLIKA

16

**“CMC EKOCON”, SHOQËRI ME PËRGGJEGJËSI TË KUFIZUAR
PRISHTINË**

STATUT
MBI THEMELIMIN E “CMC EKOCON”, SHOQËRI ME PËRGGJEGJËSI TË
KUFIZUAR PRISHTINË



PRISHTINË, DHJETOR 2003

AKT PER THEMELIMIN E NJE SHOQERIE ME PERGJEGJESI TË KUFIZUAR

Krijuar nga themeluesi Oliver Maciniq, i lindur ne 22.02.1950 (njezete e dy shkurt
njemije e nenteqind e pesedhjetete), me rezidence të perhereshme Fellerjeva Ulica, 51 (
pesedhjet e nje) Ljubljane, si me posite vijou

I. Preambul

Neni 1

Permes ketij akti themeluesi krijon nje shoqeri me pergjegjesi të kufizuar per nje periudhe
të pakufizuar kohe dhe ne të njejtën kohe perkufizon rregullat themelore të shoqerise.

II. Emri i Shoqerise dhe Selia

Neni 2

Emri i shoqerise do të jete **CMC EKOCON,eklosko svetovanje,inzeniring
terzastopanje,d.o.o**

Emri i shkurtuar i kompanise do të jete **CMC EKOCON d.o.o**

Selia e kompanise do të jete Ljubljana.

Shoqeria mund të kete dege të cilat themelohen ne nje vend të ndryshem nga vendi i
selise.

III. OBJEKTI I VEPRIMEVE

Neni 3

Aktiviteti i kompanise do të kete objektivat e meposhteme :

28.5 Trajtimi dhe veshja e metaleve, perpunimi i pergjithshem inxhinieriko mekanik

29.1 Prodhimi i makinerive per fuqi mekanike, per avionet, motoret

29.2 Prodhimi i makinerive me qellime të tjera të pergjithshme

29.5 Prodhimi i makinerive të tjera me qellime të posaçme

33.2 Prodhimi i instrumentave dhe paisjeve per matje etj.

33.3 Prodhimi i paisjeve mbi kontrollin ndaj procesit industrial

45.2 Ndertimi i konstruksioneve të plota apo i pjeseve të tyre qe kane të bejne me
inxhinierine civile,

45.3 Ndertimi i instalimeve

45.4 Perfundimi i ndertimit

51.1 Shitja me shumice mbi baze gjobe apo kontrate

51.2 Shitja me shumice e grurit e faterave dhe ushqimeve shtazore

51.4 Shitja me shumice e mallrave shtepiake

- 51.5 Shitja me shumice e produkteve ndermjetese jobujqesore, skrapit dhe mbetjeve
- 51.9 Shitje të tjera me shumice
- 52.4 Shitje të tjera me pakice të mallrave të rinj ne dyqane të specializuara
- 52.5 Riparimi i të mirave personale dhe shtëpiake
- 65.2 Ndermjetesime të tjera financiare
- 67.1 Operacione ndihmese ndaj veprimit financiar, me perjashtim të sigurimeve dhe pensioneve
- 70.2 Leshimi i pasurise
- 71.3 Dhenia me qera e pajisjeve dhe makinerive të tjera
- 74.1 Konsulence ligjore, kontabilitet, mbajtje bogarish dhe studim i tregut
- 74.2 Aktivitete arkitekturale dhe inxhinierike dhe sherbime të tjera të lidhura me të
- 74.4 Reklame
- 74.8 Aktivitete të tjera biznesi qe nuk jane klasifikuar ne kete liste
- 93.0 Aktivitete të tjera sherbimi

IV. Investimet kryesore dhe kapitali i shoqerise

Neni 4

Kapitali i shoqerise shkon ne 150,000,000.00 SIT (njeqind e pesedhjet milion 00/100) SIT

Investimet kryesore të ortakëve ne shoqeri shkojne ne:

Nr.	Ortaku	Adresa	Kontributi Neushkruar	Pjesa Kapitalit
1	Oliver Maciniç lindur 22.02.1950	Ellerjeva Ulica, 51, Ljubljane	135.000,000.00 SIT	90%
2	CMC EKOCON,eklosko svetovanje, inzeniring terzastopanje,d.o.o (pjesa e kapitalit)	100 ZAPOLJE- LOGATEC, LOGATEC	15.000,000.00 SIT	10%
		TOTALI	150.000,000.00 SIT	100%

Neni 5

Investimet kryesore duhet të dorezohen shoqerise ne nje menyre të tille qe drejtuesi i shoqerise të kete kompetence të lire per disponimin e tyre.

Neni 6

Nje nga format e mundshme të sigurimit të mjeteve financiare të nevojshme per veprimin e shoqerise eshte pagesa e kontributeve ne kesh, ne formen e pagesave shtese. Para

dorezimit të pagesave shtese duhet të aprovohet një vendim dhe të regjistrohet në librin e vendimeve.

V. Shpenzimet e krijimit të kompanisë

Neni 7

Të gjitha shpenzimet e krijimit dhe të gjitha shpenzimet e lidhura me ndryshimet e statusit të shoqërisë do të jenë në ngarkim të kompanisë.

VI. Marrdheniet ndermjet kompanisë dhe partnerit

Neni 8

Shoqëria mund të përfojë aksionet e saj të biznesit nëse kontributet paguhen plotësisht. Megjithatë ajo nuk mundet të ekzekutojë ndonjë pagesë për përfitimin e aksioneve të tilla të biznesit, derisa ajo të ketë krijuar rezervat për aksionet e saj në përputhje me legjislacionin e vlefshëm. Shoqëria nuk mund të përfojë të gjitha aksionet e biznesit.

Neni 9

Ortaku mund të tjetërsojë pjesën e tij të biznesit në interesin e tij apo pjesërisht nga ku një biznes i pavarur krijohet. Ndarja e një pjese të biznesit lejohet gjithashtu dhe në rastin e trashëgimit.

Vlera e pjesës së biznesit të mbetur dhe vlera e pjesës së re të biznesit nuk mund të jete me e ulët sesa minimumi i kërkuar ligjor për vlerën.

Neni 10

Transaksionet ligjore, të hyra në fuqi nga partneri për llogari të kompanisë me veten si pale tjetër, duhet të jete me shkrim me përjashtim të transaksioneve ligje në rrjedhën e veprimtimit të zakonshëm.

VII. Asambleja

Neni 11

Shoqëria CMC EKOCON ekološko svetovanje inženiring terzastopanje.d.o.o. ka përftuar një pjesë biznesi si aksionin e tij privat të biznesit, nga e cila ai nuk ushtron ndonjë të drejtë, përveç të drejtës së pronësive për të marrë pjesë në rritjen e kapitalit aksioner përmes mjeteve të dhëna nga shoqëria. Për shkak të kësaj arsye e gjitha vendimi marrja në shoqëri do të zbatohet sikur shoqëria të ishte një shoqëri me ortak të vetëm.

Neni 12

Themeluesi do të aprovoje vendimet qe vecanerisht kane të bëjne me:

- Aprovimi me bilabnein vjetor, deklaratën e fitimit dhe humbjes dhe perdorimin e fitimit;
- pagesat vijuese dhe rimbursimet e tyre;
- emerimin dhe shkarkimin e drejtorit,
- masat per rishikimin dhe shqyrtimin e punes të drejtorit
- emerimin e nje perfaqesuesi dhe prokuren e posacme të biznesit
- zbatimin e pretendimeve të shoqerise ne lidhje me drejtorin persa i perket rimbursimit të demit të ndodhur ne procesin e themelimit apo gjate veprimtarise të shoqerise
- perfaqesimi i shoqerise ne procedura gjyqsore të ndermarra kunder drejtorit
- ceshnje të tjera të caktuara me ligj, nga ky akt themelimi apo akte të pergjithshme të shoqerise.

Neni 13

Ortaku duhet të miratoje vendimet e tij të cilat duhet të adoptoje si nje ortak mbi bazen e ligjeve, apo ketij akti përmes vendime të regjistruara ne librin e vendimeve, të vertetuara nga noteri publik.

VIII. Drejtori

Neni 14

Shoqeria do të perfaqesohet nga nje drejtor i cili do të menaxhoje shoqerine. Nje prokure e posacme mund të parashikojë të gjitha aktet ligjore të cilat hyjne ne sferen e zotesise juridike të shoqerise.

Shoqeria mund të leshoje prokure.

Drejtori i shoqerise mund të jete themeluesi i nje pale të trete, të emeruar nga themeluesi si drejtor i shoqerise.

Drejtori mund të jete i punesuar ne shoqeri apo mund të jete nje person i cili nuk eshte i punesuar ne shoqeri.

Neni 15

Drejtori i shoqerise ne rast se nuk eshte themeluesi(ortak i vetem), do të emerohet per nje periudhe të caktuar ne nje vendim mbi emerimin, të aprovuar nga themeluesi(ortaku i vetem). Ne kete rast themeluesi mund të shkarkoje apo pezulloje drejtorin ne cdo kohe, pavaresisht faktit nese ai ishte i emeruar per nje periudhe të kufizuar apo të pakufizuar kohe.

Neni 16

Pervec të drejtave dhe detyrimeve, të cilat drejtori i ka sipas ligjit, të drejta dhe detyrime të tjera do të parashikohen nga një kontratë ndërmjet drejtorit dhe shoqërisë.

IX. Deklarata financiare dhe raportet e biznesit.

Neni 17

Shoqëria do të mbajë të gjitha librat e biznesit dhe të hartojë raporte sipas ligjit.

Shoqëria do të përpilojë deklarata financiare dhe raporte biznesi për vitin financiar që barazohet me vitin kalendarik.

Afëtet e fundit për dorëzimin e deklaratave financiare dhe raportet e biznesit të cilat nuk janë parashikuar nga ligji do të parashikohen në një akt të veçantë të shoqërisë.

Neni 18

Shoqëria do të mbajë librat e biznesit në përputhje me ligjin dhe në bazë të dokumentave autentik të kontabilitetit.

Neni 19

Veprimet financiare do të kryhen në përputhje me standartet dhe parimet financiare të paracaktuar nga një agjensë ligjesh të autorizuar dhe në respektim të akteve të brendshme të përgatitura në përputhje me legjislacionin.

X. Mbarimi i shoqërisë.

Neni 20

Shoqëria do të mbarojë:

- nëse do të vendosë kështu nëpërmjet një vendimi;
- nëse gjykata do të vendosë që regjistrimi është i pavlefshëm;
- nëse falimenton;
- nëpërmjet një urdhëri gjykatë në përputhje me paragrafin e dytë të nenit 455 të ligjit mbi shoqëritë tregtare;
- përmes shkrirjes në një kompani tjetër;
- nëse kapitali aksioner (fillëstar) ulët poshtë minimumit të lejuar ligjor

XI. Ndryshimi i aktit të themelimit

Neni 21

Ortaku do të vendosë për ndryshimin e aktit të themelimit me anën e një vendimi.

Drejtori do të raportojë ndryshimin e aktit të themelimit për regjistrimin në regjistrin e gjyqes.

XII.Dispozitat e fundit

Neni 22

Akti i themelimit do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit

Neni 23

Drejtori i shoqërisë do të aplikojë për regjistrimin e shoqërisë në regjistrin e gjyqes.

Lubjana, 28.01.2004 (njezet e tete tetor dymije e kater)

ORTAKU

Oliver MACINIÇ
Nënshkrimi

Okrožno Sodišče v Ljubljani
Oddelek Za Gospodarsko Sodstvo
Tavčarjeva 9, Si-1503 LjubljanaREDNI IZPISEK IZ SODNEGA REGISTRA
IZPISAN NA DAN 21.07.2004Srg zadnjega vpisa : 200115495 Matična številka : 5393396
Datum zadnjega vpisa : 08.10.2001 Vložna številka : 10796600
Ustanovitev : 10.07.1990Srg : 200115495
Datum vpisa : 08.10.2001
Firma : CMC EKOCON
ekološko svetovanje, inženiring ter zastopanje
d.o.o.
Krajšana firma : CMC EKOCON d.o.o.
Sedež : 1000 LJUBLJANA, Tbilisijska 81
Org. oblika : d.o.o.
Dod. org.oblika :
Osnovni kapital : 14.000.000,00
Sodišče : Okrožno sodišče v Ljubljani
Status vpisa : Redno

D E J A V N O S T I :

Šifra	Naziv Dejavnosti	Vpis	Srg
28520	Splošna mehanična dela	08.10.2001	200115495
29120	Proizvodnja črpalk in kompresorjev	08.10.2001	200115495
29130	Proizvodnja pip in ventilov	08.10.2001	200115495
29200	Proizvodnja hladilnih in prezračevalnih naprav, razen za gospodinjstva	08.10.2001	200115495
29300	Proizvodnja metalurških strojev	08.10.2001	200115495
29520	Proizvodnja rudarskih in gradbenih strojev	08.10.2001	200115495
29560	Proizvodnja strojev za druge posebne namene	08.10.2001	200115495
33200	Proizvodnja merilnih, kontrolnih, preizkuševalnih, navigacijskih in drugih instrumentov in naprav, razen opreme za industrijsko procesno krmiljenje	08.10.2001	200115495
33300	Proizvodnja opreme za industrijsko procesno krmiljenje	08.10.2001	200115495
45210	Splošna gradbena dela	08.10.2001	200115495
45310	Električne inštalacije	08.10.2001	200115495
45320	Izolacijska dela	08.10.2001	200115495
45330	Vodovodne, plinske in sanitarne inštalacije	08.10.2001	200115495
45340	Druge inštalacije pri gradnjah	08.10.2001	200115495
45450	Druge zaključna gradbena dela	08.10.2001	200115495
5112	Posredništvo pri prodaji goriv, rud, kovin, tehničnih kemikalij	04.11.1996	199603851

51130	Posredništvo pri prodaji lesa in gradbenega materiala	08.10.2001	200115495
51140	Posredništvo pri prodaji strojev, industrijske opreme, ladij, letal	08.10.2001	200115495
